

URDHËR
Nr. 56, datë 4.2.2025

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PUBLIK, GJIMNAZI “SHABAN DEMIRAJ”, VLORË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 4, të kreut I/B, të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve parauniversitare publike” të ndryshuar, dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë.

2. Institucioni arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë, ka për detyrë:
a) të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë–Himarë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

b) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë–Himarë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë–Himarë, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë;

b) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar publik;

c) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier, të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Vlorë–Himarë për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve, nga institucioni arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Vlorë–Himarë, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë–Himarë dhe institucioni arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Orjana Osmani